

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, me bashkëpunëtorin profesional Fatlum Halimi, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditësve: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që të dy nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Vitisë, të cilët me autorizim i përfaqëson [REDAKTUAR] avokat nga Ferizaj, kundër të paditurave: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që të dyjat më parë nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, tani me adresë të panjohur, të cilat sipas ligjit i përfaqëson Përfaqësuesi i Përkohshëm, [REDAKTUAR] avokat nga Ferizaj, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, në seancën e mbajtur më datën 05.11.2018 merr këtë:

AKT GJYKIM

I. APROVOHET në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësve: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që të dy nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Vitisë, si e bazuar.

II. VËRTETOHET se paditësit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] janë bashkëpronarë secili me 1/2 të pjesës ideale të pronësisë të paluajtshmërisë kontestuese, gjegjësisht ngastrës kadastrale nr. P-72217090-01962-0 në sipërfaqe prej 31004 m², me kulturë mal – tokë pyjore, e cila gjendet në vendin e quajtur “Prroni i Kaqakëve” Z.K. Tankosiq/ Dardani, Komuna Kadastrale Ferizaj, konform ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë [REDAKTUAR], në bazë të parashkrimit fitues.

III. DETYROHEN të paditurat: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që të dyjat më parë nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, tani me adresë të panjohur, që t’ua lejojnë paditësve ndryshimet në regjistrat kadastral konform këtij Aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, në të kundërtën ky Aktgjykim do t’u shërben paditësve si titull juridik për ndryshimin në regjistrat kadastral, konform dispozitivit të tij.

IV. OBLIGOHEN solidarisht paditësit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], që Përfaqësuesit të Përkohshëm [REDAKTUAR] avokat nga Ferizaj, t’ia paguajnë shumën prej 1,617.60 €.

Arsyetimi

Paditësit me datë 06.04.2018 kanë paraqitur padi pranë kësaj Gjykate, me të cilën kanë kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë për ngastrën kadastrale të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të marrëveshjes gojore të shitblerjes dhe mbajtjes në mirëbesim.

Me që të paditurave nuk u dihej vendbanimi aktual, paditësit gjatë seancës përgaditore, i kanë propozuar Gjykatës që të paditurave t’u caktohet përfaqësuesi i përkohshëm. Në këtë rast Gjykata e ka aprovuar propozimin e tillë dhe me vendimin C.nr.320/18 të datës 27.04.2018 të paditurave u’a ka caktua për Përfaqësues të Përkohshëm

██████████ avokat nga Ferizaj. Poashtu paditësit kanë kërkuar edhe nxjerrjen e provës dhe vërtetimin e gjendjes faktike përmes ekspertit të gjeodezisë si dhe kanë propozuar të dëgjohen dëshmitarë, të cilat kërkesa janë aprovuar nga Gjykata gjatë shqyrtimit përgjithor.

Gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësve ka deklaruar se mbetemi në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe deklarojmë se paluajtshmërinë kontestuese paditësit me marrëveshje gojore e kanë blerë nga të paditurat në vitin 1990, me ç'rast e kanë paguar në tërësi çmimin e shitblerjes dhe kanë hyrë menjëherë në posedim të paluajtshmërisë kontestuese, të cilën paluajtshmeri e shfrytëzojnë që nga koha e shitblerjes e deri më sot pa u penguar apo shqetësuar nga askush. Andaj, i autorizuari i paditësve ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe që paditësit të shpallen pronarë të paluajtshmërisë lëndore, në bazë të shitblerjes dhe mbajtjes e shfrytëzimit me mirëbesim të paluajtshmërisë.

Përfaqësuesi Përkohshëm i të paditurave gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se pas administrimit të provave, dëgjimit të dëshmisë së dëshmitarëve dhe analizimit të ekspertizës gjeodezike, kam ardhur në përfundim se për mua si përfaqësues i përkohshëm i palëve të paditura, janë sqaruar mjaftueshëm faktet dhe rrethanat për të vendosur lidhur me pretendimet e paditësve të shprehura si në kërkesëpadinë e tyre, andaj, konsideroj se tashmë janë përmbushur kushtet që gjykata në këtë çështje kontestimore, të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të mbështetur në ligj.

Me qëllim të vërtetimit plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar provat dhe faktet e çështjes, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka bërë administrimin e tyre me si vijon: *certifikatën e pronësisë e dt.26.02.2018; ekspertizën gjeodezike të dt.01.11.2018 e punuar nga eksperti gjeodet ██████████, së bashku me skicën e matjeve dhe raportin përshkrues; dëshmitë e dëshmitarëve ██████████ dhe ██████████*

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave të çështjes, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka bërë vlerësimin e tyre veç e veç dhe të ndërlidhura mes veti, si tërësi, dhe mbi bazën e bindjes së lirë të krijuar mbi bazën e fakteve dhe provave të çështjes, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dëshmitari ██████████ nga fshati ██████████ deklaroi se paditësit i ka fqinjë dhe edin faktin se paditësit e kanë blerë rronën kontestuese nga të paditurat për çmimin dikun rreth 12 – 13 mijë DM dhe kjo ka ndodhur diku në vitin 1990. Në vazhdim dëshmitari deklaroi se i kujtohet se të paditurat i kanë kërkuar paditësve që ta paguajnë tatimin në pronë. Mëtej dëshmitari deklaroi se e din faktin se ku gjendet prona kontestuese dhe me cilat ngastra tjera kufizohet, e sa i përket shfrytëzimit të saj nga paditësit, nuk i ka parë ata duke e shfrytëzuar këtë pronë, por vetë ka dijeni dhe informata nga të tjerët se paditësit e kanë shfrytëzuar këtë pronë.

Dëshmitari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] deklaroi se me paditësin e parë [REDACTED] kanë qenë kolegë të punës në fshatin [REDACTED] dhe se i kujtohet fakti që paditësi i ka treguar dëshmitarit se e ka blerë një tokë në sipërfaqe prej 3 hektarësh në vitin 1990 nga [REDACTED] të cilën pronë e ka blerë për çmimin rreth 13 mijë DM e paguar me kundërvlerë në dinarë, dhe i kujtohet që e paditura [REDACTED], e cila ishte grua e [REDACTED], diku në vitin 1995 i ka dërguar disa njerëz te [REDACTED] dhe ka kërkuar që të paguaj tatimin e kësaj prone. Gjithashtu, e din faktin se nga vitet 1990-ta e në vazhdim, [REDACTED] e ka punuar pa problem këtë tokë dhe se nuk ka pasur asnjë pengesë nga të paditurit apo nga personat tjerë dhe me që edhe dëshmitari e posedon një tokë në afërsi të pronës kontestuese, e ka parë disa herë [REDACTED] duke shkuar me paisje bujqësore te prona kontestuese.

Dëshmitari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] deklaroi se e ka të ditur faktin se paditësit e kanë blerë pronën kontestuese nga [REDACTED] diku në vitet 1990-ta, të cilit i'a kanë paguar çmimin e shitblerjes dhe menjëherë kanë hyrë në posedim dhe shfrytëzim të papenguar dhe i kujtohet fakti se gruaja e [REDACTED] e paditura [REDACTED] ka kërkuar nga paditësit të paguajnë tatimin në pronë për tokën kontestuese. Mëtej dëshmitari shton se sipërfaqja e tokës është dikund mbi 3 hektarë, ku paditësi i dytë [REDACTED] ka pjesëmarrje rreth 50 ari dhe se nga koha e blerjes së kësaj toke, paditësit i kanë ndarë secili pjesën e vet që i takon, e me që [REDACTED] e ka djal të vëllaut, i ka rastisur që pjesën e tij ta punoj edhe vet dëshmitari.

Gjykata ka dalur në vend të ngjarjes dhe përmes ekspertit të gjeodezisë, gjeo. [REDACTED] ka konstatuar se gjendja faktike dhe juridike është në përputhshmëri me njëra tjetrën. Nga ekspertiza gjeodezike është konstatuar se prona kontestuese është e evidentuar si: ngastra kadastrale nr. 1962-0 në sipërfaqe prej 31004 m², me kulturë: Mal i klasit I, vendi i quajtur "Proni i Kaqakëve", e cila evidentohet në emër të dy bashkëpronarëve: [REDACTED] (e veja e [REDACTED]) dhe [REDACTED] secila me nga ½ të pjesës ideale të bashkëpronësisë.

Nga deklarimi i palëve ndërgjyqësore, dëshmitarëve dhe provave të administruara në këtë procedurë, Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Se paditësit pronën objekt shqyrtimi e kanë blerë në vitin 1990 nga të paditurit, në bazë të marrëveshjes gojore. Poashtu, është vërtetuar se paditësit i'a kanë paguar në tërësi çmimin e shitblerjes të paditurave menjëherë pas lidhjes së marrëveshjes interne të shitblerjes. Nga dëshmia e dëshmitarëve dhe nga konstatimi i gjendjes faktike përmes ekspertit të gjeodezisë, gjykata ka konstatuar se paditësit pronën kontestuese e kanë në posedim dhe shfrytëzim të vazhdueshëm dhe të papenguar nga askush që nga viti 1990 e në vazhdim.

Gjykata gjatë administrimit të provave në këtë çështje juridike, deklarimet e palëve dhe përfaqësuesve të tyre, konstatoi shfrytëzimin me mirëbesim të pronës kontestuese për më shumë se 28 vite dhe mbi këtë bazë paditësit e fitojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën kontestuese. Pra, në këtë rast Gjykata vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore që paditësit të shpallen pronarë të pronës kontestuese, sepse nga ana e tyre janë plotësuar të gjitha kushtet kumulative për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e mbajtjes me mirëbesim mbi 20

vite (28 vite) dhe se Gjykata i vërtetoi këto fakte nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, konstatimet nga vendi i ngjarjes, dëshmia e dëshmitarëve dhe provat tjera materiale të administruara në këtë procedurë kontestimore, andaj Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar në tërësi dhe e njejta duhet të aprovohet.

Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 28 të Ligji për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore dhe nenit 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.


Lidhur me shpenzimet e procedurës Gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK-së, ashtu që i ka detyruar paditësit në mënyrë solidare t'i paguajnë shpenzimet e tarifës së Përfaqësuesit të Përkohshëm, në shumë të përgjithshme prej 1,617.60 € dhe atë: për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 208.00 €, për tri seanca të mbajtura nga 405.60 € apo të triat së bashku në shumë prej 1,216.80 dhe për një seancë të shtyer shumën prej 202.80€.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.320/18 me datë 05.11.2018



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

Dana: 04. 02. 20 19